

Gjatë fushatës elektorale për zgjedhjet komunale 2017, Demokraci Plus u ka kërkuar kandidatëve për kryetarë të shtatë komunave që të zotohen formalisht se do t'u përmbahen disa parimeve bazë të qeverisjes së mirë nëse zgjedhen për ta udhëhequr komunën.

Njëra ndër to është zotimi se do të mbahen konsultime publike në lagje dhe fshatra. Pasi që në fazën e hartimit të buxhetit mbahen konsultime me qytetarë, D+ ka monitoruar këto takime për të vlerësuar angazhimin e komunave për t'i konsultuar qytetarët për buxhetin e vitit 2019.

Arsyeja pse është përzgjedhur ky zotim është që të fuqizohet qeverisja e mirë, bazë e së cilës është pjesëmarrja qytetare në draftim të politikave lokale përfshi buxhetin, për një qeverisje gjithëpërfshirëse. Shtatë komunat më të mëdha në vend: Prishtina, Prizreni, Ferizaj, Peja, Gjakova, Gjlani dhe Mitrovica, janë përzgjedhur për monitorim në këtë aspekt për arsye se përmbushja e zotimeve nga këto komuna duhet të shërbejë si shembull për komunat më të vogla përreth në vendosjen e standardeve më të larta të parimeve të qeverisjes së mirë në qeverisjen lokale në Kosovë.

Kjo analizë shqyrton procesin e konsultimit publik për buxhetin komunal në këto komuna, si dhe jep sugjerime se si të përmirësohet ky proces i rëndësishëm i konsultimit.